



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:226341
Datë: 11.06.2024
Numri i dokumentit: 05808613

Ac.nr.9966/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehulli, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.K, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat M.H, kundër të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.M, për pagesë të kamatës dhe kompensimin e dëmit material-fitimit të humbur, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2353/14, të datës 19.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 11.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit M.K dhe VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2353/14, të datës 19.07.2021.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.2353/14, të datës 19.07.2021, ka vendosur më sa vijon:

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit M.K me të cilën ka kërkuar nga gjykata të detyrohet e paditura Këshilli Gjyqësor i Kosovës, që paditësit t'ia paguaj shumën prej 1,691.17 euro, në emër të kamatës prej 3.5% për periudhën nga data 01.06.2000 e deri më datë 12.12.2012 për shumën e mjeteve në lartësi prej 3,425.66 euro si dhe shumën prej 1,469.96 euro, në emër të fitimit të humbur për shkak të privimit të kundërligjshëm nga liria nga data 21.12.2000 e deri më 21.05.2001, krejt këto në shumën e përgjithshme prej 3,161.13 euro dhe atë në afatin 15 ditor pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm, E PABAZUAR.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësi në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si në ankesë.

E paditura nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi M.K, me datën 28.08.2014, pranë gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurës, për shkak të kompensimit të demit, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se e paditura Këshilli Gjyqësorë të Kosovës, me Urdhëresën P.nr.85/2000 të datës 01.07.2014, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, ka kthyer tek paditësi të hollat në shumën prej 32.770.00 DM, përkatësisht kundërvlera në euro, në shumën prej 3.425,66 euro, shumë kjo e sekuestruar si rezultat i procedurës penale të zhvilluar ndaj paditësit, e cila procedurë ka përfunduar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit PAKR.nr. 725/12 më datën 03.04.2014, pastaj të paditurës Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, i ka lindur detyrimi për kthimin e mjeteve në fjalë që nga data e shpalljes së aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, me të cilën procedura penale ka marrë formën e prerë, pasi që deri në këtë moment, mjetet në fjalë, nuk janë mbajtur në mënyrë të kundërligjshme nga e paditura, pasi që sekuestrimi i tyre, ka qenë veprim i ligjshëm në kuadër të procedurës penale të zhvilluar ndaj paditësit. Andaj, pretendimi i paditësit se në shumën e sekuestruar ka rrjedhur kamata prej 3.5% përgjatë periudhës prej datës 01.06.2000 e deri më 21.07.2014 është i paqëndrueshëm. Në rast se e paditura mjetet në fjalë nuk do t'ia kthente paditësit edhe pas përfundimit të procedurës penale, vetëm atëherë do mund të vinte në shprehje detyrimi i të paditurës që përveç kryegjësë, që paraqet shumën e sekuestruar prej 3.425,66 euro, të paguaj edhe kamatën ligjore për këtë shumë.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit mes tjerash ka deklaruar se paditësi, ka dështuar të ofroj prova me të cilat do mund të vërtetonte faktin se i njëjti, për shkak të pamundësisë së disponimit të mjeteve në vlerën prej 3,425.66 euro për periudhën nga 01.06.2000 deri me datë 21.07.2014 ka pësuar dëm në formën e fitimit të humbur. Paditësi nuk ka paraqitur asnjë provë që do mund të vërtetonte faktin se disponimi me shumën prej 3,425.66 euro për gjatë kohës së sekuestrimit, të njëjtit do t'i sillte ndonjë dobi pasurore, dobi e cila është pamundësuar si rezultat i veprimeve të të paditurës. Paditësi, përveç deklarimeve subjektive të tij se para arrestimit ka pasur aktiv një biznes të peregjistruar të cilën pas privimit nga liria është detyruar ta mbyll, me asnjë provë të vetme nuk ka arritur ta provoj këtë fakt. Për më tepër, në lidhje me këtë pjesë të kërkesëpadisë, paditësi veç se ka nënshkruar Marrëveshje jashtëgjyqësore me të paditurën me ç' rast është kompensuar për dëmin material dhe fitimin e humbur përgjatë periudhës sa ka qenë i privuar në mënyrë të kundërligjshme nga liria, andaj paditësi, nuk ka ofruar prova se përtej asaj çka është kompensuar në procedurë jashtë gjyqësore, të ketë pësuar dëm tjetër i cili ka mbetur i pa përmbushur nga ana e të paditurës. Me rastin e vendosjes gjykata është bazuar në nenin 136 dhe nenin 173 të LMD-së, ndërsa lidhur shpenzimet procedurale ka vendosur duke u bazuar në nenin 452.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i

përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e as në shkeljet e pretenduara me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i të paditurit për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse me provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor, mjaftueshëm është provuar se ndërgjyqësit me datën 03/07/2014 kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e të gjitha formave të dëmit të pësuar si pasojë e heqjes së lirisë, e po ashtu ndërgjyqësit në këtë marrëveshje e kanë paraparë klauzolën se me pranimin e kësaj oferte, e privon parashtruesin e kërkesës (në këtë rast paditësin) nga e drejta e kompensimit të dëmit në procedurën përkatëse pranë gjykatës kompetente, të cilën marrëveshje në mënyrë vullnetare e ka nënshkruar i autorizuari i paditësit dhe përfaqësuesi i të paditurës dhe njëkohësisht janë pajtuar me të paditurën që marrëdhëniet juridiko-detyrimore lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, ti shuajnë me marrëveshje si dhe në mënyrë vullnetare. Sipas nenit 8.2 të LMD-së parashihet: *Detyrimi mund të shuhet vetëm me pajtimin e vullneteve të pjesëmarrësve në marrëdhënien e detyrimeve ose në bazë të ligjit*, ndërsa neni 276.1 të LMD-së po ashtu ka paraparë: *Detyrimi shuhet kur ai përmbushet si dhe në rastet tjera të përcaktuara me ligj*. Në rastin konkret nuk ishte kontestues fakti se e paditura e ka përmbushur detyrimin e parapara sipas marrëveshjes jashtëgjyqësore dhe e paditura i ka respektuar procedurat ligjore me kohë duke lëshuar urdhëresën për kthimin e sendeve të konfiskuara paditësit dhe atë në lartësi prej 6,700.00 DM, të cilën shumë e ka konfiskuar Policia e Kosovës sipas Listës së Evidencës TE-000527-0879 e datës 01/06/2020, ndërsa paditësi gjatë shqyrtimit kryesor me provat e administruara nuk ka arritur të vërteton bazën juridike të kërkesëpadisë. Sipas nenit 7.1 të LPK-së është paraparë: *Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*, ndërsa neni 319.1 të po këtij ligji ka paraparë: *Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta* ndërsa neni 322.3 i po këtij ligji ka paraparë: *Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër*.

Nga një gjendje e tillë faktike e konstatuar dhe vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese edhe sa i përket zbatimit të gabuar të ligjit material, pasi që për tu plotësuar kushti ligjor i paraparë me nenin 136 të LMD-së, me të cilën dispozitë shprehimisht përcaktohet: *Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij*, domosdoshmërisht duhen të plotësohen këto parakushte: Të ekzistojnë subjektet e marrëdhënieve detyrimore dhe të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar respektivisht duhet të ekzistoj shkakuesi i dëmit dhe i dëmtuari, të ekzistojë fakti dëmtues, nga rrjedh dëmi, të ekzistoj dëmi i shkaktuar, të ekzistoj lidhja shkakësore ndërmjet faktit dëmtues dhe dëmit të shkaktuar si dhe të ekzistoj kundërligjshmëria e veprimit, përkatësisht e mosveprimit nga

është shkaktuar dëmi, të cilat kushte duhen të plotësohen në mënyrë komulatiuve. Në rastin konkret me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk është vërtetuar përgjegjësia e të paditurës për demin e shkaktuar mbi bazën e fajësisë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.9966/21, me datë 11.06.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku